

V E N D I M

Nr.36, datë 31.1.1994

PËR DHËNIEN E LEJEVE PROFESIONALE NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË KULLOTAVE

Me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave krijohet Komisioni për dhënie e lejeve profesionale në fushën e studimit, të projektimit e të zbatimit të punimeve të ndryshme në sektorin e pyjeve.

2. Personat fizikë a juridikë të interesuar në fushat e studimit, të projektimit e të zbatimit të punimeve të ndryshme në sektorin e pyjeve dhe kullotave, të pajisen me leje profesionale nga drejtoritë e bujqësisë, në bashkëpunim me drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe, në përputhje me rregulloren e Komisionit për dhënie e lejeve profesionale.

3. Çdo leje tjetër ose ushtrim profesioni i këtij karakteri në kundërshtim me këtë vendim janë të pavlefshëm.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, në bashkëpunim me ministritë e tjera, sipas fushave përkatëse, të hartojë rregulloren për dhënie e lejeve profesionale, si dhe udhëzimin përkatës për detyrat, të drejtat e procedurat e organizimit të punës së Komisionit.

5. Rregullorja dhe udhëzimi i Komisionit për dhënie e lejeve profesionale miratohen nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Meksi